



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 456 Prot.

Tiranë, më dt. 24. 11.2017

VENDIM

Nr. 341, dt. 24.11.2017

Në mbështetje të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 24.11.2017, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

KONSTATOI SE:


Njolla e projektit të propozuar nuk përputhet me njollën e dokumentacionit hipotekor. Paraqitja grafike e projektit nuk është e saktë dhe ka mospërputhje të orientimeve të fasadave të projektit. Sa më sipër,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë projektin “Rikonstruksion, Adaptim banese e shtesë kati në Lagjen “Pazar i Vjeter”, Gjirokastër, të banesës Gramoz Kovaci”, hartuar nga Ark. Rest. Jorgo Xuhano.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Mirela Kumburo Furxhi



SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

Arta Dollani